

Bëhuni pjesë e programit “Rini në Aksion”



ALBANIAN

Shpresojmë që informacioni i
kësaj broshure do t'ju
ndihmojë të zbuloni mundësitë
e ofruara nga programi
“Rini në Aksion” i Komisionit
Europian, do t'ju lehtësojë
procesin e aplikimit dhe do t'ju
nxisë të zhvilloni projekte me
të rinjtë.

ACKNOWLEDGEMENTS

This booklet was translated by:
Visar Shehu

We would like to thank him and all the others that contributed to this project.

Produced by: SALTO Cultural Diversity Resource Centre;
Susie Green, Antonio Gomes, Martin Schippan
Designer Sónia Garcia

A keni dëshirë të merrni pjesë në mundësi të reja dhe të zhvilloni projekte jashtë vendit? A dëshironi të bashkëpunoni me partnerë të kulturave të tjera dhe të nxisni të rinjtë të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në krijimin e projekteve që do të kenë ndikim në komunitetin lokal? A dëshironi të jetoni jashtë vendit dhe të krijoni miq të rinj?

Bëhuni pjesë e programit “Rini në Aksion”!

Çfarë është ‘Qytetari Evropian’?	02
Çfarë do të thotë ‘Pjesëmarrje e të rinjve’?.....	02
Çfarë është ‘Shumëllojshmëria Kulturore’?.....	02
Çfarë kuptojmë me ‘Përfshirjen e njerëzve me mundësi të kufizuara’?.....	02
SHKËMBIMET RINORE.....	04
INICIATIVA RINORE.....	05
PROJEKTET DEMOKRATIKE RINORE.....	06
SHËRBIMI VULLNETAR EUROPIAN.....	07
RINIA NË BOTË.....	08
PROJEKTET TRAJNUESE DHE RRJETËZIMET.....	08
MBËSHTETJA PËR BASHKËPUNIM EUROPIAN NË FUSHAT RINORE....	09
FORMA E APLIKIMIT.....	10
MENAXHIMI I PROJEKTIT	13
KARTELA RINORE.....	16
FJALOR.....	16



Programi **“Rini në Aksion”** është hartuar për të gjithë të rinjtë aktivë dhe kreativë, apo punëtorët rinorë me qëllim që t’i pajisë ata me një sistem për t’i realizuar idetë dhe potencialet. Ky sistem është i ndërtuar nga katër shtylla (ide) kryesore që janë përshkruar më poshtë:



Çfarë është ‘Qytetari Evropian’?

Qytetari Evropian u vjen në ndihmë njerëzve në Evropë që të kujdesen për komunitetet dhe të zbulojnë vlerat rrënjësore të demokracisë dhe lirisë. Ai ka për qëllim t’u japë të rinjve shansin që të shkëmbejnë kulturën e tyre me të rinj të tjerë të kulturave, vendeve, feve, kualifikimeve arsimore të ndryshme apo me të rinj të cilët jetojnë dhe mendojnë ndryshe.

Mendo se çfarë mund të bësh që Europa e sotme dhe e ardhme të jetë vend i tolerancës dhe solidaritetit!

Çfarë do të thotë ‘Pjesëmarrje e të rinjve’?

Të rinjtë e sotëm janë vendimarrësit e së nesërme, prandaj programi “Rini në Aksion” dëshiron t’i nxisë të rinjtë të jenë pjesë aktive e shoqërisë dhe t’u ofrojë atyre mundësinë të modelojnë komunitetin e tyre dhe Europën. Projektet e zhvilluara nën programin “Rini në Aksion” u mundësojnë të rinjve t’i menaxhojnë projektet e tyre dhe të marrin vendime. Në shumë projekte ka qenë e dobishme që një apo më shumë njerëz të kenë eksperiencë menaxhimi të cilët do ta fasilitojnë (lehtësojnë) procesin e zbatimit të projektit.

Çfarë është ‘Shumëllojshmëria Kulturore’?

Respektimi i prejardhjes kulturore si dhe vendosmëria për të luftuar kundër racizmit dhe ksenofobisë (antipatia ndaj të huajve) është thelbi i programit “Rini në Aksion”. Ky program mbështet projektet dhe aktivitetet në të cilat të rinjtë e kulturave të ndryshme, feve dhe kombësive të ndryshme mund të punojnë së bashku për të arritur qëllimet si: toleranca ndaj shumëllojshmërisë, solidariteti, respekti dhe mirëkuptimi ndërkulturor.

Çfarë kuptojmë me ‘Përfshirjen e njerëzve me mundësi të kufizuara’?

Programi “Rini në Aksion” është i dizenuar për të rinj me prejardhje të ndryshme edukative, socio-ekonomike, kulturore apo gjeografike, si dhe të rinjve në nevojë. Për këtë arsye grupet rinore dhe organizatat të cilat aplikojnë për mbështetje për projektet e tyre mund të marrin mbështetje financiare shtesë për të mbuluar shpenzimet e veçanta në mënyrë që të sigurojnë që të gjitha target grupet (duke përfshirë të rinjtë me nevoja të veçanta) të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara.



Fondet për projektet e “**Rini në Aksion**” janë në dispozicion prej vitit 2007 deri në fund të vitit 2013 për:

Shkëmbimet Rinore mundësi që një grup të rinjsh të takojë grupe të tjera nga vende të ndryshme dhe të mësojnë për kulturat e njëri-tjetrit gjatë punës së përbashkët në një temë specifike.

Iniciativat Rinore mbështetja e grupeve rinore për të zhvilluar idetë e tyre dhe për të vënë në realitet zbatimin e një projekti. Gjithashtu ekziston mundësia të ndërtohen rrjete me partnerë nga vende tjera dhe të krijohet një projekt i përbashkët.

Projektet Demokratike Rinore nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset demokratike, në nivel lokal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.

Shërbimi Vullnetar European mundësia për të rinjtë që të jetojnë jashtë vendit, të mësojnë për kulturën dhe vendin dhe të mbështesin një projekt në nivel lokal.

Rinia në Botë pothuajse e njëjtë sikurse Shkëmbimet Rinore apo projektet e mbështetura nga Sistemi Mbështetës Rinor, por me partnerë nga Vendet Partnere Fqinje të Bashkimit European

Sistemi Mbështetës Rinor mbështet zhvillimin e projekteve kualitative duke bërë lidhjen mes punëtorëve rinorë dhe organizatave, shkëmbimin e ideve dhe praktikave, të nxënit dhe të zhvilluarit përmes seminareve dhe trajnimeve.

Mbështetje për Bashkëpunimet Europiane në Fushat Rinore mbështetja e bashkëpunimit dhe bisedimeve të strukturuar në mes të të rinjve dhe përgjegjësve për politikat rinore.



SHKËMBIMET RINORE

Shkëmbimi Rinor është një projekt që mbledh/afron grupet rinore të moshave midis 13 dhe 25 vjeç duke ju ofruar atyre mundësinë për të diskutuar tema specifike dhe në të njëjtën kohë të mësojnë për vendet dhe kulturat e njëri-tjetrit. Bazuar në numrin e Vendeve Partnere nga të cilat grupet e ndryshme vijnë, një Shkëmbim Rinor mund të jetë bilateral (dy vende), trelateral (tri vende) apo multilateral (më shumë se katër vende).

Të gjitha grupet e përfshira planifikojnë Shkëmbimet Rinore së bashku. Secili projekt duke përfshirë fazën përgatitore dhe vlerësimin mund të zgjasë deri në 15 muaj.

Aktiviteti i shkëmbimit rinor (kur të gjithë pjesëmarrësit mbledhen së bashku) mund të zgjasë 6 - 21 ditë (duke mos llogaritur ditët e udhëtimit) dhe duhet të zhvillohet në njërin nga vendet iniciatore.

Përbërja e grupeve pjesëmarrëse në Shkëmbime Rinore:

- _Shkëmbimet Rinore Bilaterale: minimumi 8 pjesëmarrës për grup
- _Shkëmbimet Rinore Trelaterale: minimumi 6 pjesëmarrës për grup
- _Shkëmbimet Rinore Multilaterale: minimumi 4 pjesëmarrës për grup
- _Numri maksimal i pjesëmarrësve për projekt: 60
- _Secili grup kombëtar duhet të ketë nga një apo dy udhëheqës(e) grupi

Mbështetja financiare:

Programet “Rini në Aksion” mbështesin përgatitjen e grupeve, Vizitë Paraprijëse Planifikuese, shpenzimet e udhëtimit (70%), akomodimin, ushqimin, shpenzimet e veçanta, aktivitetet pasuese dhe vlerësuese brenda aktivitetit.

SHEMBULL:

Shkëmbimi Rinor bilateral i quajtur “Koha e lirë dhe vullnetarizmi në zonat urbane” në Itali, ka përfshirë 20 të rinj nga Portugalia dhe Italia. Shkëmbimi ka pasur për qëllim përgatitjen e të rinjve 16 - 18 vjeçarë me një sistem të punës vullnetare. Programi ka qenë i kombinuar me aktivitete praktike ku të rinjtë të organizuar në skuadra kanë provuar aktivitete të ndryshme vullnetare. Në të njëjtën kohë secili grup pjesëmarrës ka prezantuar kulturën dhe historinë e vendit të vet.




INICIATIVA RINORE

Iniciativa Rinore është mjet i mrekullueshëm për të rinjtë nga 18 - 20 vjeç që t'i transformojnë idetë e tyre në praktikë duke iniciuar, organizuar dhe zhvilluar projektet e tyre. Të rinjtë janë përgjegjës të planifikojnë, zhvillojnë dhe vlerësojnë projektin. Sidoqoftë, ekziston mundësia për të angazhuar një trajner, i cili mund t'i mbështesë ata për të krijuar një projekt kualitativ. Këto projekte duhet të zgjasin 3 – 18 muaj dhe mund të zhvillohen në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Iniciativa Rinore mund të organizohet nga një organizatë apo grup rinor joformal, por edhe nga dy apo më shumë grupe të vendeve të ndryshme nga Vendet Partnere.

Kjo është një mundësi për të rinjtë që të provojnë idetë e tyre, të vetëdijësohen për shtetësinë e tyre europiane dhe mënyrat se si mund të kontribuojnë në ndërtimin e Europës.

Temat e projektit Iniciativa Rinore mund të jenë të lidhura me artin dhe kulturën, ambientin, mbrojtjen e trashëgimisë, informimin rinor, zhvillimin rural/urban, politikat rinore, shëndetin, anti-racizmin, mbështetjen e njerëzve me nevoja të veçanta, edukimin nga shokët, sportet rinore, kohën e lirë të të rinjve, median & komunikimin etj.



Mbështetja financiare:

Programi “Rini në Aksion” mbulon të gjitha shpenzimet direkte lidhur me realizimin e projektit (deri në një nivel të caktuar), si akomodimin, ushqimin, shpenzimet e veçanta, dhe mbështetet përfshirjen e trajnerit. Për Inicativat Rinore Ndërkombëtare, mbështeteten financiarisht edhe Vizitat Paraprijëse Planifikuese dhe shpenzimet e udhëtimit (70%).

SHEMBULL:

12 të rinj nga Turqia kanë përpiluar një projekt me qëllim organizimin e kurseve bazë për njohuri kompjuterike për fëmijët të cilët punojnë në rrugë. Grupi ka bashkëpunuar me një klub lokal të rinjsh, të cilët punojnë rregullisht me këta fëmijë. Bazuar në bisedimet me fëmijët, ky grup ka mësuar për gjendjen e tyre dhe i ka pyetur ata se çfarë do të kishin dëshirë të bënin. Gjatë bisedimeve ata kanë shfaqur idenë për kurse kompjuteri. Kursi ka zgjatur tre muaj dhe projekti ka përfshirë 70 fëmijë.

PROJEKTET DEMOKRATIKE RINORE

Projektet Demokratike Rinore mbështesin pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike në nivel lokal, rajonal apo kombëtar, si dhe në atë ndërkombëtar. Këto projekte u mundësojnë të rinjve 13 – 30 vjeçarë, të cilët janë banorë të vendeve partnere të krijojnë rrjete të reja, shkëmbime dhe të përhapin praktikatat e mira në fushat e pjesëmarrjes së të rinjve dhe qytetarëve.

Për Projektet Demokratike Rinore nevojiten minimumi 16 pjesëmarrës nga dy vende të ndryshme. Duhet të jenë së paku dy grupe aktive në secilin vend dhe projekti mund të zgjasë për 6 – 18 muaj duke përfshirë edhe fazën përgatitore dhe atë vlerësuese.

SHEMBULL:

40 të rinj nga 11 Vende të Programit janë takuar për 10 ditë për të stimuluar punën dhe vendimarrjen e Parlamentit Europian. Pjesëmarrësit kanë zgjedhur presidentin e Parlamentit të tyre dhe gjithashtu kanë krijuar grupet parlamentare dhe komitetet për të diskutuar çështje të përbashkëta të cilat janë aktuale në axhendën e BE-së dhe që janë të lidhura me jetën e të rinjve në Europë. Pas fazës përgatitore e cila është bazuar në dokumentat e vërteta të Parlamentit Europian, ata kanë imituar sesionet plenare të Parlamentit Europian.

SHËRBIMI VULLNETAR EUROPIAN

Ky shërbim u ofron të rinjve 18 - 30 vjeçarë mundësinë të kalojnë një periudhë kohe si vullnetarë në një ambient tjetër, të shumëllojshëm në një vend të huaj deri në një vit. Shërbimi Vullnetar European nuk kërkon kualifikim të posaçëm dhe është i hapur për të gjithë të rinjtë. Vullnetarëve u sigurohet udhëtimi dhe akomodimi, si dhe u ofrohen “para xhepi” si kontribut për të mos shpenzuar paratë personale. ‘Shërbimi Vullnetar European’ është një lidhje në mes të tre palëve: vullnetarit, Organizatës Dërguese (përgjegjëse për përgatitjen dhe dërgimin e vullnetarit) dhe Organizatës Pritëse (përgjegjëse për vendosjen e vullnetarit, programin e aktiviteteve dhe mirëqenien e tij).

Këto projekte përfshijnë punën në qendra rinore, punën me të moshuar, mbështetjen e iniciativave për mbrojtjen e ambientit apo riciklimit dhe projektet për trashëgimi kulturore. Në këtë program nuk përfshihen ndërhyrje në vendet post-konflikt që paraqesin rrezikshmëri të lartë (p.sh. ndihmat humanitare, ndërhyrja në fatkeqësi, etj.).

Për t’i përmbushur detyrat vullnetari mund të marrë trajnime specifike në tema të ndryshme: p.sh. organizimi i aktiviteteve me të rinj; nxënia për çështjet ndërkulturore; ndërtimi i grupit; menaxhimi i kohës dhe konflikteve dhe mendimi kreativ.

Shërbimi Vullnetar European u ofron të rinjve mundësinë që të bëjnë ndryshime në komunitetin lokal jashtë vendit dhe të fitojnë aftësi të cilat mund t’i zbatojnë në komunitetet në vendin e tyre. Gjithashtu, këto aftësi mund të kenë ndikim në të ardhmen dhe karrierën e të rinjve.

Të rinjtë e papriviligjuar gjithashtu mund të bëjnë ‘Shërbim – afatshkurtër Vullnetar’ (2 javor) me mundësi të zgjatjes deri në maksimum 12 muaj nëse vullnetari shpreh dëshirë dhe ka aftësi për t’u përballur me sfidën.

SHEMBULL

Një 24 vjeçar nga Anglia, i cili ka qenë në burg dhe i pas-trehë ka filluar të punojë si vullnetar në një organizatë bam-irëse sepse nuk mund të gjente punë. Aty ai ka dëgjuar për mundësinë e pjesëmarrjes në ‘Shërbimin Vullnetar Euro-pian’. Edhe pse kurrë më parë nuk ishte larguar nga Anglia, ai e pranoi sfidën dhe shkoi në një projekt në Poloni, i cili i dha një mundësi të ndihmojë në rinovimin e parkut të një bashkësie lokale. Pasi u kthye ai e përshkroi eksperiencën e tij si “një nga momentet më të mira të jetës” dhe vendosi që t’i kthehet projektit edhe për katër muaj. Ai gjithashtu mori pjesë në përvjetorin e 10-të të Komisionit Evropian si delegat zyrtar i “Shërbimit Vullnetar Evropian”.


RINIA NË BOTË

Kjo lloj iniciative mbështet aktivitetet e grupeve joformale dhe organizatave nga Vendet Partnere dhe Vendet Partnere Fqinje. Sikurse Shkëmbimet Rinore edhe ky aktivitet mbështet dialogun, tolerancën, ndërgjegjësimin ndërkulturor dhe solidaritetin, me qëllim që të ndalojë paragjykimet dhe stereotipet dhe të ndërtojë një shoqëri të bazuar mbi respektin dhe demokracinë kudo në botë.

Ky aksion ndihmon për krijimin e projekteve bashkëpunuese në fushat rinore e në veçanti Shkëmbime Rinore, trajnime dhe mundësi për rrjetëzime.

SHEMBULL:

Një organizatë nga Gjeorgjia dhe një grup Britanik kanë iniciuar një shkëmbim rinor shumëkulturore me titull "Europa takon Tokën e Medeas – Shkëmbim Rinor kundër Stereotipeve dhe Ksenofobisë për të përkrahur Mirëkuptimin Ndërkulturore" në Gjeorgji. Projekti ka përfshirë gjashtë grupe të rinjsh nga Ukraina, Gjeorgjia, Rusia, Anglia, Estonia dhe Gjermania. Secili grup përbëhej nga katër pjesëmarrës dhe një udhëheqës.



PROJEKTET TRAJNUESE DHE RRJETËZIMET

Të gjithë individët e interesuar apo të angazhuar në edukimin joformal dhe punën me të rinj (punëtorët dhe udhëheqësit rinorë, këshilluesit rinorë, trajnerët, ligjvënësit) që legalisht banojnë në Vendet e Programit mund t'i bashkohen cilitdo nga Trajnimet apo Rrjetëzimet e përshkruara më poshtë:

Pasqyrim praktikash qëndrim i shkurtër jashtë vendit tek një organizatë partnere me qëllim që të shkëmbehen praktikat e mira, të fitohen aftësi dhe njohuri përmes vëzhgimit aktiv.

Vizitë paraprake takim i shkurtër me partnerë potencial për të shqyrtuar mundësinë e organizimit të projektit ndërkombëtar. Qëllimi kryesor i vizitës është të përmirësohet dhe të zhvillohet bashkëpunimi i filluar dhe të pregatitet projekti për të ardhmen.

Takimi vlerësues takim i planifikuar me partnerët për të vlerësuar takimet e kaluara, seminarët, trajnimet etj.


Vizitë studiuese program studiues që fokusohet në një temë të veçantë dhe informon për punën rinore dhe dispozitat vepruese të të rinjve në një vend.

Aktivitet për Ndërtimin e Bashkëpunimit organizim i cili u mundëson pjesëmarrësve të gjejnë bashkëpunëtorë për të bashkëvepruar dhe për të zhvilluar projekte ndërkombëtare.

Seminari një organizim me temë të veçantë që ofron mundësinë për të diskutuar dhe shkëmbyer përvojat e mira rreth një teme të zgjedhur e cila është e lidhur ngushtë me fushën e punës me të rinj.

Trajnimet/Kurset program edukativ për t'i ngritur kompetencat, njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e pjesëmarrësve. Trajnimet/kurset duhet të çojnë drejt rritjes së cilësisë së punës me të rinj, veçanërisht përsa i përket projekteve të zhvilluara nën Programin 'Rini në Aksion'.

Rrjetëzimi krijimi, përforcimi dhe zgjerimi i rrjeteve.



MBËSHTETJA PËR BASHKËPUNIM EUROPIAN NË FUSHAT RINORE

Kjo pjesë e Programit “Rini në Aksion” mbështet bashkëpunimet, seminarët dhe bisedimet e strukturuar, të bazuara në principet e të mësuarit joformal në mes të të rinjve, në veçanti të atyre që janë aktivë në punën me rininë dhe atyre që janë përgjegjës për politikat rinore. Ky aktivitet ka për qëllim të:

nxisë bashkëpunimin në mes të administratave, ligjvënësve dhe të rinjve përmirësojë njohuritë dhe mirëkuptimin e të rinjve përmirësojë njohuritë dhe mirëkuptimin e të rinjve

Projektet duhet të zhvillojnë një apo disa kombinime të pikave në vijim:

Takimet rinore Kombëtare

_Takime për t'u dhënë hapësirë debateve dhe informatave mbi temat që janë të lidhura me bisedimet e strukturuar apo politikat dhe temat e Bashkimit European

_Përgatitja bazë për organizimin e manifestimit zyrtar rinor nga Udhëheqësit e Anëtarësisë të Presidencës së Bashkimit European

_Organizimi i aktiviteteve të lidhura me ‘Javën Rinore Europiane’

_Përmirësimin e dialogut ndër-sektorial dhe bashkëpunimit në fushën e edukimit formal dhe joformal

Seminarët Rinore Ndërkombëtare

_Mbledhja e të rinjve dhe ligjvënësve për të diskutuar, shkëmbyer idetë dhe praktikat e mira dhe për të adaptuar rekomandimet mbi tematikën e prioritetëve dhe objektivave të ‘Bisedimeve të Strukturuar: të ‘Metodës së Hapur të Koordinimit’ në fushat rinore dhe ‘Pakti European për Rininë’. Për këto lloj projektsh ju duhet të gjeni 30 apo më shumë pjesëmarrës nga së paku 5 vende të ndryshme të Vendeve të Programit.

FORMA E APLIKIMIT

Për të aplikuar për fonde nën Programin “Rinia në Aksion” ju duhet të plotësoni formën e aplikimit sipas tipit të projektit që planifikoni të zhvilloni.

Formatet e aplikimit mund t’i shkarkoni në: www.ec.europa.eu/youth/youth-in-action-programme/doc411_en.htm

Kur aplikoni për fonde mos harroni:

_të dorëzoni formën korrekte të aplikimit, të përfunduar komplet dhe të datuar
_të përfshini të gjitha dokumentet e kërkuara në aplikim (p.sh. plani buxhetin që mendoni se është i nevojshëm për të zhvilluar projektin)

_të nënshkruhet nga personi i cili e përfaqëson projektin

_të dërgoni aplikimin me postë para datës së fundit për aplikim



Gjatë vitit ekzistojnë afate të ndryshme për të aplikuar:

Projektet që fillojnë në mes të	Afati i fundit për aplikim
1 Maj dhe 30 Shtator	1 Shkurt
1 Korrik dhe 30 Nëntor	1 Prill
1 Shtator dhe 31 Janar	1 Qershor
1 Dhjetor dhe 30 Prill	1 Shtator
1 Shkurt dhe 31 Korrik	1 Nëntor



Mbështetja financiare

Pavarësisht nga tipi i projektit që organizoni, ju mund të merrni mbështetje për:

_Shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrës – Shpenzimet e udhëtimit, të cilat duhen të jenë të klasës ekonomike dhe me çmim sa më të ulët.

_Akomodimi - Shpenzimet e ushqimit gjatë aktiviteteve (jepen në shumë të caktuar).

_Shpenzimet për aktivitete – Shpenzimet që lidhen direkt me projektin, përfshirë edhe sigurimet (jepen në shumë të caktuar).

_Mjete për trajnim – Honorarët për trajnerët dhe për materialet e trajnimit (jepen në shumë të caktuar).

_Shpenzimet e veçanta – Çdo shpenzim i lidhur direkt me të rinjtë me nevoja të veçanta apo që justifikohen për nga natyra speciale e projektit.

_Shpenzimet për Vizitat Paraprijëse Planifikuese – Shpenzimet e udhëtimit, akomodimi dhe shpenzimet tjera gjatë vizitës.

_Shpenzimet shtesë për propagandim dhe përdorim të rezultateve të projektit.

_Shpenzimet që lidhen me pjesëmarrjen e trajnerit në projektet Iniciativa Rinore



Keni kujdes me disa nga kushtet:


_Të gjitha dokumentet e dërguara Agjensisë Kombëtare për programin “Rini në Aksion” kur aplikoni për fonde konsiderohen si dokumente të ligjshme. Do të thotë që ju jeni të detyruar të zbatoni atë që thuhet në aplikim, kontratë dhe në raportin final. Me nënshkrimin e këtyre dokumenteve ju jeni përgjegjës për atë se çfarë shkruhet në to!

_Bashkëfinancimi – paratë që merren nga programi “Rini në Aksion” nuk do të mbulojnë të gjitha shpenzimet e projektit. Për shumën që mungon ju duhet të gjeni mbështetje financiare nga organizatat tjera, institucionet apo të ngrini fonde nga donacione të tjera.

_Nuk ka financim të dyfishtë – nëse jeni mbështetur financiarisht nga programi “Rini në Aksion” ju nuk mund të pranoni ndonjë mbështetje tjetër nga Komuniteti Evropian për të njëjtin projekt.

Datat e projektit janë atëherë kur projekti fillon dhe kur përfundon. Intervali kohor në mes të dy datave është një periudhë e pranueshme, që do të thotë se vetëm shpenzimet gjatë kësaj periudhe mund të mbulohen nga programi “Rini në Aksion”. Biletat apo çdo gjë lidhur me projektin duhet të blihen gjatë kësaj periudhe. Kjo periudhe përfshin edhe fazën përgatitore si dhe atë të vlerësimit përfundimtar të projektit.

Datat e aktivitetit janë datat gjatë të cilave zhvillohet aktiviteti kryesor. (p.sh. dita e parë dhe e fundit e Shkëmbimit Rinor, etj.). Për këtë arsye datat e aktivitetit bien brenda projektit dhe preferohet që të mos fillojnë në të njëjtën kohë me datën e projektit, sepse shpenzimet që paraqiten para ose pas aktivitetit kryesor (faza përgatitore dhe vlerësimi final) nuk do të mbulohen nga fondet e Programit “Rini në Aksion”.



MENAXHIMI I PROJEKTIT

Cilësia e partneritetit/ pjesëmarrja aktive e të gjithë themelueseve në projekt Bashkëpunimi dhe partneriteti janë fjalët kyçe të këtyre projekteve. Organizatorët e projektit janë përgjegjës kryesorë për të garantuar pjesëmarrje aktive të gjithë partnerëve dhe për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Ja disa pika që ju duhet t'i keni parasysh për të bashkëpunuar në përsosmëri:

- niveli i rrjetit (Sa mirë punoni së bashku? Sa i mirë dhe sa i rregullt është komunikimi juaj përmes e-maileve, telefonit?)

- bashkëpunimi dhe zotimi i secilit organizator të projektit

- sigurohuni që profili dhe kualifikimi i organizatës përshtatet me qëllimet e projektit

- qartësoni dhe bini dakord për rolet dhe detyrat e secilit organizator përgjegjës për projekt

Bashkëpunimi i mirë në mes të partnerëve dhe pjesëmarrësve duhet të mbahet gjatë të gjitha fazave të projektit. Faza përgatitore & planifikuese është faza vendimtare për suksesin e projektit. Gjatë kësaj faze, organizatorët dhe pjesëmarrësit duhet të:


- bien dakord për temën e projektit

- ndajnë përgjegjësitë, programin e aktiviteteve, metodat e punës, profilin e pjesëmarrësve, përgatitjet praktike (vendin e zhvillimit, transferimet, akomodimin, përkthimin)

- përfshijnë sa më shumë pjesëmarrës të projektit në fazën përgatitore dhe planifikuese

- përgatisin pjesëmarrësit për vështirësitë e projekteve ndërkulturore gjatë takimeve me të rinj të kulturave dhe prejardhjeve të ndryshme

- këshillohet që grupi dërgues të bëjë një Vizitë Paraprijëse Planifikuese tek grupi mikpritës



Për aktivitetin kryesor ju duhet të keni program të përcaktuar qartë (Çfarë dëshironi të bëni dhe kur? Si? Çfarë synoni të mësoni me secilin aktivitet?). Aktivitetet e përdorura duhet të jenë të balancuara dhe të kenë lidhshmëri me objektivat e projektit dhe të programit “Rini në Aksion”. Programi i aktiviteteve:

Qëllimi kryesor/ Tema:	Aktiviteti (Çfarë do të bëjmë?)	Metoda (si do ta bëjmë?)	Mësimet (Pse po e bëjmë?—Si kontribuon ky aktivitet në objektivat e projektit?)
Mëngjesi:			
Pasditja:			
Mbrëmja:			

Gjatë vlerësimit final ju dhe partnerët e tjerë duhet të reflektoni mbi projektin dhe të verifikoni nëse janë arritur objektivat kryesore dhe a janë plotësuar pritshmëritë e organizatorëve dhe pjesëmarrësve, si dhe të shihen rezultatet e projektit.

Është e nevojshme të ndahet kohë për vlerësim të projektit tuaj: vlerësim para, gjatë dhe pas aktivitetit, apo edhe më tepër nëse mendoni se është e dobishme për projektin.

Mbrojtja dhe siguria e pjesëmarrësve është shumë e rëndësishme në punën me të rinjtë. Meqë ligjet dhe politikat ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin është shumë e rëndësishme të diskutohen këto çështje me partnerët nga vende të ndryshme. Por ekzistojnë disa rregulla të përgjithshme që duhet të respektohen nga të gjitha projektet dhe vendet. Ju duhet të siguroheni që:

_një numër i mjaftueshëm i udhëheqësve/organizatorëve të grupeve është prezent që t'u mundësojë të rinjve të shkëmbejnë eksperiencat e tyre në mënyrë të arsyeshme, të sigurt dhe në ambient të mbrojtur

_të keni organizatorë/udhëheqës femra dhe meshkuj kur të dy gjinitë marrin pjesë në projekt

_të keni përgatitur në kohë procedurat e emergjencës (p.sh. 24orë/7ditë detajet e kontakteve të emergjencës të vendit mikpritës, fondeve emergjente, organizatorët dhe udhëheqësit të jenë trajnuar për ndihmën e parë etj.)

_të krijohet një 'kod i përbashkët i mirësjelljes' i cili do t'i ndihmojë organizatorët edhe pjesëmarrësit të respektojnë rregullat për të cilat kanë rënë dakord (p.sh. përdorimi i alkoolit, pirja e duhanit etj.).

Kualiteti i përmbajtjes dhe metodologjisë së projektit

Tema apo qëllimi si dhe objektivat të cilat zgjidhen për projektin duhet të jenë interesante dhe të përshtatshme për pjesëmarrësit në projekt. Se çfarë prisni ju si grup të arrini përmes projektit varet si i keni detajuar objektivat, p.sh. “të mësojmë se cilat janë vlerat e përbashkëta të kulturave të Europës” ose “të mësojmë njëri- tjetrin për mënyrat e lehta të riciklimit”. Objektivat e projektit tuaj duhet të jenë të lidhura me temën e projektit dhe metodat e punës. Si hap i ardhshëm tema dhe objektivat duhet të transferohen në aktivitete konkrete të programit.

Për konstruktimin e aktiviteteve ju duhet të përdorni metoda dhe teknika të ndryshme të të nxënit joformal (Punëtori, punë ekipore, skeçe, aktivitete jashtë objekteve, aktivitete dëfryese, tryeza të rumbullakëta, etj.) në mënyrë që të adresoni nevojat e ndryshme të pjesëmarrësve dhe të arrini rezultatet e dëshiruara. Dhe në fund duhet të jetë një proces i të nxënit që stimulon kreativitetin, pjesëmarrjen aktive dhe iniciativën.

Për më shumë mjete dhe inspirim shiko tek:

www.salto-youth.net/toolbox/

Një nga objektivat kryesore të aktivitetit është të **përfshihen pjesëmarrës** sa më shumë që është e mundur dhe të stimulohet procesi i të nxënit. Të rinjtë duhet të jenë në gjendje të hulumtojnë tema të ndryshme në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh aftësitë e tyre gjuhësore apo aftësi të tjera.

Projekti juaj duhet t’u mundësojë pjesëmarrësve të kenë **vetëbesim** në rast se konfrontohen me eksperiencë, qëndrime dhe sjellje të reja dhe projekti të kontribuojë në zhvillimin personal dhe social të tyre

Ju duhet të punoni që të ngrisni vetëdijësimin e të rinjve mbi **dimensionet ndërkulturore**. Projekti duhet të ndihmojë në parandalimin dhe luftimin e paragjytimeve, racizmit dhe të gjitha qëndrimeve që çojnë tek përjashtimi, duhet të zhvillohet ndjenja e tolerancës dhe mirëkuptimit ndaj shumëllojshmërisë (diversitetit).

Ndikimi, shumëfishimi i efektit dhe vazhdimësia e projektit

Gjatë zhvillimit të projektit ju nuk duhet të përfshini vetëm të rinjtë në vendimarrje, por duhet të mundoheni të përfshini edhe njerëz të tjerë nga komuniteti, zonat lokale, etj. Organizatorët dhe pjesëmarrësit duhet të mundohen të përhapin objektivat dhe rezultatet e projektit duke punuar me shumëzuesit apo edhe duke përdorur rezultatet dhe të vazhdohet projekti me më shumë partnerë të tjerë. Duke vepruar në këtë mënyrë projekti mund të ketë ndikim më afatgjatë.

KARTELA RINORE

Çdo person që ka marrë pjesë në Projektet Trajnuese të “Rini në Aksion” do të pranojë një Kartelë Rinore – Çertifikatë. Me këtë kartelë ju do të njiheni si person që keni qenë i përfshirë dhe keni pasur eksperiencë për një kohë të caktuar në metodat joformale të të nxënies. Ky mund të jetë një përfitim i madh për të ardhmen tënde arsimore apo profesionale. Për të hyrë në Kartelën Rinore kliko në:

www.youthpass.eu

Kriteret në detaje për të dërguar aplikacionet janë të specifikuar në udhërrëfyesin e programit “Rini në Aksion” nën:

www.ec.europa.eu/youth/youth-in-action-programme/doc443_en.htm

Për mbështetje dhe informata më të hollësishme ju lutem kontaktoni Agjencinë tuaj Kombëtare për Programin “Rini në Aksion”.

www.ec.europa.eu/youth/youth/contacts_en.htm?cs_mid=152

FJALOR

Aktivitet: pjesa interaktive (bashkëvepruese) e projektit, organizuar për të dhënë rezultate

Vizita Paraprijëse Planifikuese: vizitë planifikuese tek organizata mikpritëse e zhvilluar gjatë planifikimit apo fazës së përgatitjes, para se projekti të ndodhë.

Forma e Aplikimit: nëse dëshiroi të aplikoni në programin “Rini në Aksion”, ju duhet të mbushni dhe dërgoni formën zyrtare të aplikacionit. Këtë formë mund ta shkarkoni nga faqja elektronike e Komisionit: www.ec.europa.eu/youth/youth-in-action-programme/doc411_en.htm

Aplikuesi: dikush që aplikon me një projekt për të fituar ndihmë financiare nga programi “Rini në Aksion”.

Përfitues: nëse projekti juaj përzgjidhet, ju bëheni përfitues i programit “Rini në Aksion”, që do të thotë ju do të pranoni para për zhvillimin e projektit. Ju do të nënshkruani marrëveshjen për fond, do të merrni fondin financiar për projektin tuaj dhe do të pranoni përgjegjësinë për zhvillimin e projektit.

Trajner: person i cili ka njohuri dhe punon në çështje rinore ose ka eksperiencë në Iniciativat Rinore, mbështet dhe udhëheq grupin për t'i ekzekutuar aktivitetet.

Organizata Koordinuese: është organizatori i cili merr përgjegjësinë për pjesën financiare dhe administrative të projektit, koordinimin e projektit në bashkëpunim me partnerët dhe bën shpërndarjen e fondit të BE-së në mes të organizatave tjera sipas rolit që kanë në projekt.

Kriteret e përshtatjes: këto janë kushtet të cilat projekti i juaj duhet t'i përbushë, veçanërisht kur është në pyetje target grupi, vendi i zhvillimit, kohëzgjatja dhe përmbajtja.

Fasilitatori: person që mbetet neutral sa më shumë që është e mundur gjatë projektit dhe e mban grupin të përqendruar në punë, e përfshin dhe inkurajon çdo njërin në grup. Të dëgjuarit se çfarë njerëzit thonë është një aftësi kryesore për këtë detyrë.

Raporti final: dy muaj mbas përfundimit të projektit, ju duhet të kompletoni dhe nënshkruani raportin dhe ta dërgoni në Agjencinë Kombëtare. Duhet ta përshkruani si është zhvilluar projekti dhe të llogariten aspektet aktuale financiare (shpenzimet aktuale dhe të ardhurat).

Aktiviteti pasues: disa aktivitete/projekte të zhvilluara pasi të jetë përfunduar projekti me qëllim që rezultatet e projektit të jenë të qëndrueshme dhe të rritet ndikimi.

Praktikat e mira: shembuj të projekteve të cilat kanë pasur ndikim pozitiv përmes aktiviteteve, metodave dhe rezultateve. Themeluesit e projekteve duhet vazhdimisht të shkëmbejnë eksperiencat, të përhapin njohuritë, të përdorin praktikat e mira në kontekste, ambiente e rrethana të ndryshme. Më shumë informata mund të gjeni në www.salto-youth.net

Marrëveshja mbi grantin: ky është detaj, kusht dhe nivel i fondit që të drejton si përdoren fondet e BE-së.

Udhëheqësi grupor: një i rritur (dikush që është më i vjetër se 25 vjeçar) i cili i shoqëron të rinjtë pjesëmarrës në aktivitete në mënyrë që të sigurojë nxënie efektive, mbrojtje dhe siguri për ta.

Organizata Mikpritëse (OM): organizatorët e vendit ku aktiviteti do të zhvillohet.

Grup joformal i të rinjve: grup i të rinjve të cilët mbledhen së bashku pa mbështetjen e ndonjë organizate apo strukture formale/legale.

Shtetas legal: dikush që njihet nga shteti i tij/saj si person me dokumente shtetësie legale.

Metodologjia: llojllojshmëri e metodave të edukimit joformal; procedura dhe teknika që mund të aplikohen me qëllim të adresimit të nevojave të pjesëmarrësve për të nxjerrë rezultatet e dëshiruara.

Shumëfishuesi: person i cili ka qenë i implikuar në një projekt dhe i cili shpërndan informata apo mesazhin tek një masë më e gjerë publiku/komuniteti me qëllim të rritjes së ndikimit të projektit (p.sh. të rinjtë, punëtorët rinor, por gjithashtu dhe mediat, udhëheqësit politik dhe ligjvënës të BE-së).

Agjencitë Kombëtare (AK): struktura të formuara nga Autoritetet Kombëtare në secilin Vend të Programit me qëllim që të menaxhojnë, promovojnë dhe zhvillojnë Programet “Rini në Aksion” në nivel të decentralizuar. Kontaktet e Agjencive Kombëtare mund t’i gjeni në: www.ec.europa.eu/youth/youth/contacts_en.htm?cs_mid=152

Vendet Partnere Fqinje: vendet që nuk janë Vende të Programit por programi “Rini në Aksion” mbështet bashkëpunimet në mes të Vendeve të Programit dhe Vendeve Partnere Fqinje, në vijim:

Bosnja dhe Hercegovina Kroacia Mali i Zi Maqedonia (Ish Republika e Jugosllavisë) Shqipëria Serbia	Armenia Azerbajxhani Bjellorusia Gjeorgjia Moldavia Rusia Ukraina	Algjeria Egjipti Izraeli Jordani Libani Maroku Palestina dhe Autoritetet e Bankës Perëndimore dhe Gaza Siria Tunizi
---	---	---

Partnerë: grup i cili merr pjesë në projekt në bazë të partneritetit.

Partneritet: marrëdhënia e udhëheqësve të ndryshëm të implikuar në zhvillimin e projektit. Ky bashkëpunim i afërt nënkupton përgjegjësitë për mbarrëvajtjen e operimit dhe financave për të gjithë partnerët: përcaktimi i roleve, ndarja e detyrave dhe aktiviteve.

Kohëzgjatja e projektit: e gjithë periudha e projektit, nga fillimi e gjer në fund, e cila përfshin fazën parapërgatitore, implementimin e aktiviteve dhe fazën e vlerësimit (duke përfshirë dhe reflektimin mbi mundësinë e aktiviteve pasuese).

Vendet e Programit: pjesëmarrësit dhe themeluesit e Vendeve të Programit mund të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e programit “Rini në Aksion”. Më poshtë janë Vendet e Programit:

Austria Anglia Danimarka Belgjika Bullgaria Estonia Finlanda Franca Gjermania Greqia	Hungaria Holanda Irlanda Italia Letonia Lituania Luksemburgu Malta Norvegjia	Polonia Portugalia Qipro Romania Republika e Çekisë Republika e Sllovakisë Sllovenia Spanja Suedia	Islanda Litenshtajni Turqia
---	--	--	-----------------------------------

Promotori: çdo organizatë, trupë apo grup i të rinjve të implikuar në zhvillimin e projektit “Rini në Aksion”. Pavarësisht nga roli në projekt, promotori mund të jetë partner, aplikues dhe përfutues.

Organizata Dërguese (OD): promotor që dërgon një pjesëmarrës/e apo grup duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në ndonjë aktivitet jashtë vendit.

Bëhuni pjesë e programit “Rini në Aksion”

ALBANIAN version

SALTO-YOUTH
CULTURAL DIVERSITY
RESOURCE CENTRE



SALTO-Youth is a network of 8 Resource Centres across Europe that provides information, training and support for international youth projects in the framework of the European Commission's "Youth in Action" Programme. We respond to the needs of the National Agencies of this Programme to support Inclusion and Cultural Diversity on an international level and with local impact. Our activities take place in non-formal environments (outside of schools and universities) in order to provide youth leaders with specific skills and competencies that they can then utilise and multiply in their own communities. Our core aim is to encourage the quality and quantity of youth projects across Europe. You can find more information about us at: www.salto-youth.net